



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1541 prot.

Tiranë më 21.2.2020

Lënda: Mbi draft Aneksin 1 të Marrëveshjes “Për menaxhimin dhe zhvillimin e portalit të regjistrave të biznesit të Rajonit të Evropës Juglindore”

QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Tiranë

Në vijim të shkresës tuaj nr.15973/1 Prot., datë 27.01.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim draft Aneksin 1 të Marrëveshjes “Për menaxhimin dhe zhvillimin e Portalit të Regjistrave të Biznesit të Rajonit të Evropës Juglindore”, kuptojmë që, sipas pikës 3.4 të nenit 3 të marrëveshjes së nënshkruar, portali i regjistrave të biznesit të Rajonit të Evropës Juglindore, nuk do të synojë krijimin e bazave të të dhënave të centralizuara të regjistrave, mbajtjen e të dhënave personale apo ruajtjen e të dhënave thelbësore për kompanitë.

Referuar argumenteve tuaja, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), do të transferojë vetëm të dhëna të cilat në përputhje me ligjin nr.9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, janë publike në faqen zyrtare të QKB.

Meqenëse palët nënshkruese të kësaj marrëveshje, janë vende me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave bazuar në Vendimin nr.8, datë 31.10.2016 të Komisionerit, “Për caktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, dhe faktit që QKB merr përsipër garantimin për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit vlerëson se draft Aneksi 1 i marrëveshjes, nuk bie ndesh me parimet e ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

